

*Shih konkluzionin KK-Prizren
në shtojcë mbraja p.*

Në bazë të nenit 3 al 1. pika b të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45, nenit 46. alineja 6. e nenit 47. alineja 3. të Ligjit mbi planifikimin dhe rregullimin e hapësirës ("Fl.zyrtare e Kosovës", nr. 2/89) e aplikueshme sipas Rregullores të PSSP të KB nr. 1/99, nenit 19 al. 1 pika 2 e nenit 39. al. 7. të Statutit të Komunës së Prizrenit, Asambleja Komunale në mbledhjen e vet të mbajtur, më 2 maj 2002 mori këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT DETAL URBANISTIK PËR PJESËN E LAGJES „BAZH DARANA“

Neni 1.

Me këtë Vendim bëhet aprovimi i Planit Detal Urbanistik të një pjese të lagjes "Bazhdarana" në Prizren (në tekstin e mëtejme PDU-së).

Neni 2.

Plani Detal Urbanistik për këtë pjesë të qytetit parasheh ndërtimin e banesave kolektive (etazhe) edhe ate 3 (tre) llamella me katshmeri të godinave – B+P+4+Nk si dhe llamella e mesme me B+P+5.

Neni 3.

Lokacioni i cili është parapar për ndërtim të banesave shtrihet në pjesën veriore të qytetit e quajtur ("Bazhdarana") rruga për kazermë përkatësisht "Qazim Berisha" ku do të ndërtohen gjithsej 45 banesa, çdo llamellë nga 15 banesa me 2 deri 3 dhomëshe e orientimi i tyre do të jetë verilindje dhe jugperendim, pjesa lindore është dedikuar për parkingje, kurse perdhësa është dedikuar për lokale afariste që gjithësej janë 18 lokale.

Neni 4.

Ndërtimi i objekteve banesore do të locohen në ngastrat kadastrale nr. 293 që ka sip. prej 14 ari e 31 m² si dhe në ngastrën kadastrale nr. 4793 që ka sip. prej 8 ari e 69 m² e që gjithsej parcelat kapin një sipërfaqe prej 23 ari.

Neni 5.

Vendimi mbi aprovimin e Planit Detal Urbanistik (PDU-së) është i përpilaur në pjesën grafike në përpjestim 1:200, dhe e njëjta është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 6.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Ndërtim, Rindërtim e Zhvillim dhe Drejtoria për çështje Pronoro-Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 7.

Ky Vendim hyn në fuqi me ditën e aprovimit të së njëjtit dhe do të shpallet në "Kumtar".

KUVENDI I KOMUNËS

Asambleja Komunale

Nr: 01/011-53

Më 2 maj 2002



Kryeshafi Ekzekutiv
Qamil Buzhala

Kryetari i Kuvendit
Mr. Egrem Kryezju

Administratorja Komunale
Sujata Saunik